



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TROPOJË

Në Bajram Curri më datë 30.01.2018

### ANALIZË

#### E PUNËS SË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TROPOJË PËR VITIN 2017

Pas një periudhe një vjeçare ju paraqesim bilancin e punës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tropojë, të Prokurorëve dhe Oficerëve të Policisë Gjyqësore në ushtrimin e ndjekjes penale për vitin 2017, duke pasqyruar në mënyrë të plotë treguesit e punës për këtë vit, problemet e evidentuara, marrëdhëniet e punës mes Prokurorëve dhe Oficerëve të Policisë Gjyqësore si dhe të stafit administrativ dhe marrëdhëniet e punës me Drejtues të Shërbimeve të Policisë Gjyqësore dhe institucioneve të tjera si dhe prioritetet e punës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tropojë për vitin 2017.

Treguesit e punës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë për vitin 2017, janë si më poshtë:

#### **Treguesit e përgjithshëm të ndjekjes penale**

Në vitin 2017, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë ka mbartur nga viti 2016, 33 procedime penale. Gjatë vitit 2017 janë regjistruar 268 procedime penale. Kanë ardhur me transferim nga prokuroritë e tjera 5 procedime penale. Janë rifilluar hetimet për 56 procedime penale të pezulluara gjatë viteve, për të cilat është paraqitur kërkesa në gjykatë për pushimin e tyre për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale.

Gjithsej gjatë vitit 2017, kanë qenë në hetim 362 procedime penale në hetim.

Gjatë vitit 2017, janë përfunduar hetimet për 250 procedime penale dhe kanë mbetur në hetim të mbartura 112 procedime penale.

Nga viti 2016 janë mbartur në gjykim 41 procedime penale. Gjatë vitit 2017, janë dërguar për gjykim 98 procedime penale. Gjithsej kanë qenë në gjykim gjatë vitit 2017, 139 procedime penale.

**Gjatë vitit 2017**, janë përfunduar në gjykim 108 procedime penale me 122 të pandehur, ndër të cilët 32 me masa sigurimi. Kanë mbetur të mbartura në gjykim 31 procedime penale, me 35 të pandehur, me 11 me masa sigurimi. Janë gjykuar me gjykim të zakonshëm 8 çështje me 11 të pandehur, janë gjykuar me gjykim të shkurtuar 95 çështje me 104 të pandehur, janë gjykuar me gjykim në mungesë 5 çështje me 6 të pandehur. Duket theksuar se një pjesë e dosjeve penale të dërguara për gjykim pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve në Kodin e Procedurës Penale, janë dërguar kërkesat për gjykim për 29 procedime penale dhe gjykata ka pranuar kërkesën 15 procedime penale për dërgimin në gjykim themeli, ndërsa nuk ka përfunduar shqyrtimi për 12 procedimeve penale, të cilat kanë mbetur të mbartura për vitin 2018.

### **Gjatë përfaqësimit në gjykim janë kërkuar nga prokurorët masa dënimi si më poshtë:**

Për 10 të pandehur është kërkuar dënim me gjobë, për 6 të pandehur është kërkuar dënim në minimumin e dispozitës, për 15 të pandehur është kërkuar dënim mesatar, për 87 të pandehur është kërkuar aplikimi i nenit 59 të Kodit Penal, për 2 çështje me 2 të pandehur është kërkuar pushimi i çështjes.

### **Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor janë dhënë këto masa dënimesh:**

Për 12 të pandehur gjykata ka dhënë dënim me gjobë, për 8 të pandehur ka dhënë dënim në minimumin e dispozitës, për 13 të pandehur ka dhënë dënim mesatare, për 80 të pandehur ka aplikuar nenin 59 të Kodit Penal, për 1 të pandehur ka dhënë dënim në maksimumin e dispozitës, për 1 të pandehur ka dhënë dënim afër maksimumit të dispozitës, për 3 çështje me 3 të pandehur ka vendosur pushimin e çështjes dhe për 1 çështje me 4 të pandehur ka dhënë pafajësi.

**Janë apeluar 2 vendime të gjykatës për 5 të pandehur**, për të cilët është kërkuar prishja e vendimit të gjykatës dhe dënimi i të pandehurve, si dhe është bërë apel kundërshtues për 12 raste të apelimit të vendimeve të gjykatës për masa dhe lloje dënimi. Për 3 vendime të gjykatës, për të cilat është ushtruar apel kundërshtues Gjykata e Apelit ka përfunduar shqyrtimin gjyqësorë duke lënë në fuqi vendimet e Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë, ndërsa për të gjitha rastet e tjera të apelimeve të vendimeve si dhe të apelimeve kundërshtuese shqyrtimi gjyqësorë në apel nuk ka përfunduar.

### **Gjatë vitit 2017, janë pushuar hetimet për 115 procedime penale.**

Dosjet e pushuara kanë qenë kryesisht për vepra penale të parashikuara nga nenet 290/1, 275, 150, 151 të Kodit Penal, si dhe dosje penale të pezulluara gjatë viteve të kaluara dhe të rifilluara me qëllim pushimin e tyre për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale. Po ashtu duhet theksuar si problematike për dojet e pushuara se për shkak të largësisë me Tiranën si dhe mungesës së shumë ekspertëve të fushave të ndryshme në Tropojë shumë herë jemi të detyruara të regjistrujmë procedime

penale, të cilat në momentin e regjistrimit nuk mund të konstatohet se veprimi ose mosveprimi i plotëson elementët e veprës penale pa kryer më përpara ekspertimet përkatëse teknike kriminalistike, siç jemi përpara rastit të veprave penale në fushën e shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor, mjekësisë ligjore, etj. Për shkak të largësisë, vonesës në kthimin e akteve të ekspertimit dhe mungesës së ekspertëve mjekoligjorë dhe të tjerë, jemi të detyruar të regjistrojmë procedimin penal pasi deri në ardhjen e aktit të ekspertimit kalojnë afatet për të vendosur mosfillimin e procedimit penal. Po ashtu një pjesë e mirë e procedimeve penale janë procedime të regjistruara për vepra penale që ndiqen mbi bazën e ankimit të dëmtuarit, të cilet më pas kanë tërhequr ankimin e bërë nga ana e tyre. Po ashtu theksojmë se pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve në Kodin e Procedurës Penale për procedimet penale janë dërguar në gjykatë kërkesa për pushimin e hetimeve për 54 procedime penale. Gjykata ka pranuar pushimin e procedimeve penale për 42 procedime, ndërsa janë në proces gjykimi dhe kërkesat për pushimin e 12 procedimeve penale, të cilat kanë mbetur të mbartura për vitin 2018.

### **Gjatë vitit 2017, janë pezulluar hetimet për 35 procedime penale**

Procedimet penale të pezulluara kanë qenë në të shumtën e rasteve procedime penale të regjistruara për veprat penale të vjedhjes së pasurisë kryesisht vjedhje të vogla banale, vepra penale të kultivimit të bimëve narkotike, si vepra penale të falsifikimit të dokumenteve apo dhe shkatërrimit të pronës me zjarr.

Nga hetimi i këtyre procedimeve të pezulluara vlen të theksohet se kanë ardhur dhe si pasojë e dobët e punës së seksionit të Policisë Gjyqësore në Komisariatit të Policisë Tropojë. Vihet re se për veprat penale të vjedhjes dhe kultivimit të bimëve narkotike, policia gjyqësore seksioni i Policisë së Shtetit, kryen veprimet e para në vendngjarje dhe nuk vijon hetimet me kujdes për identifikimin e autorësisë së veprës penale dhe mbledhjes së provave apo informacioneve për identifikimin e autorësisë së ngajres. Po ashtu pas referimit të materialit në prokurori dhe delegimit të dosjes penale për hetim vërehet se veprimet e kryera nga policia gjyqësore janë më shumë veprime për të kryer detyrat e lëna nga prokurori dhe nuk i kushtohet kujdes hetimit të tyre për mbledhjen e provave dhe marrjen e informacioneve, të cilat mund të ndihmojnë në gjetjen dhe administrimin e provave dhe autorësisë së ngjarjes, duke rezultuar me dështim të hetimeve në një numër shumë të madh të procedimeve penale. Po ashtu shkak për dështimin e hetimeve dhe pezullimin e çështjeve penale është edhe mungesa e oficerëve të Policisë Gjyqësore profesioniste dhe lëvizjeve shumë të shpeshta të Policisë Gjyqësore sidomos në sektorin e krimeve të lehta në komisariat.

### **Gjatë vitit 2017, janë transferuar 2 procedime penale**

Procedimet penale të transferuara janë procedime me autorë të mitur, për veprat penale të parashikuara nga nenet 291 dhe 134 i Kodit Penal dhe janë transferuar për

kompetencë lëndore hetimi në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, seksioni i hetimit të veprave penale me autorë të mitur.

### **Nga viti 2017, kanë mbetur në hetim të papërfunduara 112 procedime penale**

Megjithë përpjekjen për përfundimin e hetimeve në kohë kanë mbetur pa u përfunduar një numër i madh dosjesh në hetim, kjo për disa arsye të mëposhtme:

-Numri i madh i procedimeve penale në hetim gjatë vitit 2017.

-Mungesa e oficerëve profesionalistë në seksionin e Policisë Gjyqësore pranë Komisarariatit të Policisë Tropojë dhe sidomos lëvizjeve të shpeshta të tyre gjë që ka sjellë për pasojë vonesa dhe moshetimin e procedimeve penale në kohë dhe me profesionalizëm. Po ashtu rezulton se për shkak të lëvizjeve të shpeshta të oficerëve të Policisë Gjyqësore ka pasur raste që për të njejtat procedime penale është bërë zëvendësimi i oficerëve të Policisë Gjyqësore dy herë brenda një muaji.

-Mungesa e stafit në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë përsa i përket Policisë Gjyqësore. Theksojmë se në prokurori është vetëm një oficer i Policisë Gjyqësore, i cili ka një ngarkesë shumë të madhe dosjesh në hetim, kjo dhe për faktin se seksioni i Policisë Gjyqësore në komisariatin e policisë Tropojë ka mungesa të theksuara për sa i përket si numrit të oficerëve të policisë, por edhe profesionalizimit të tyre.

-Lëvizjet e shpeshta të prokurorëve për shkak të komandimeve në rrethe e detyra të tjera nga mesi i vitit 2017 dhe po ashtu edhe në fund të vitit, fakt që ka shkaktuar pamundësinë e prokurorëve për të kontrolluar kryerjen e veprimeve hetimore në kohë nga policia gjyqësore.

-Shtimi i volumit të punës së prokurorëve për shkak të ndryshimeve në Kodin e Procedurës Penale, pasi gjatë pjesës më të madhe të kohës prokurori është i angazhuar në gjykatë me gjykimet e kërkesave paraprake dhe ato të themelit.

Duhet theksuar se një pjesë e mirë e procedimeve të mbartura nga viti 2017, janë përfunduar tashmë gjatë muajit janarë të vitit 2018.

### **Gjatë vitit 2017, është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 74 materiale kallëzuese të regjistruara si kallëzime penale.**

Theksojmë se një pjese e madhe e materialeve, për të cilat është vendosur mosfillimi i procedimit penal janë për vepra penale të shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor kur për shkak të pasojave të lehta nuk rezultojnë elementët e veprës penale të parashikuara nga nenet 99, 199, 150, 151, të Kodit Penal, etj.

Gjatë vitit 2017, janë ankimuar 3 raste të mosfillimeve të procedimit penal; ku për një rast gjykata ka vendosur kthimin e akteve për vijimin e hetimeve, ku pas kryerjes se hetimeve shtesë çështja ka kaluar për gjykim me dy të pandehur; në një rast gjykata ka lënë në fuqi vendimin e mosfillimit dhe në një rast gjykata e Apelit

ka vendosur kthimin e çështjes për rigjykim në shkallën e parë, çështje e cila vijon të jetë në gjykim.

### **Treguesit e masave personale të sigurimit**

**Janë arrestuar në flagrancë** nga policia gjyqësore 20 të dyshuar për kryerjen e veprave penale.

**Janë ndaluar** me urdhër të prokurorit 5 të dyshuar për kryerjen e veprave penale.

**Janë paraqitur në gjykatë 24** kërkesa për vlerësimin e arrestimit dhe caktimin e masave të sigurimit.

**Janë paraqitur në gjykatë 2** kërkesa për caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg” në mungesë.

Për 9 të arrestuar është kërkuar masa e sigurimit personal “arrest në burg”.

Për 1 të arrestuar është kërkuar masa e sigurimit “arrest në shtëpi”.

Për 2 të arrestuar është kërkuar masa e sigurimit “arrest në burg” me afat.

Për 1 të arrestuar është kërkuar masa e sigurimit “garanci pasurore”.

Për 12 të arrestuar është kërkuar masa e sigurimit “detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”.

**Gjykata ka vlerësuar të ligjshme** të gjitha arrestimet/ndalimet e të dyshuarve për kryerjen e veprave penale dhe ka caktuar masa sigurimi për të gjithë të arrestuarit/ndaluarit si më poshtë;

Për 8 të arrestuar gjykata ka vendosur masën e sigurimit personal “arrest në burg”.

Për 2 të arrestuar gjykata ka vendosur masën e sigurimit “arrest në shtëpi”.

Për 2 të arrestuar gjykata ka vendosur masën e sigurimit “arrest në burg”, me afat.

Për 12 të arrestuar gjykata ka vendosur masën e sigurimit “detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”.

Për 2 të dyshuar gjykata ka vendosur masën e sigurimit “arrest në burg”, në mungesë.

Masat e sigurimit të vendosura nga gjykata kanë qenë në përputhje me kërkesat e prokurorit, prandaj nuk ka pasur raste të apelimeve të vendimeve të gjykatës. Po ashtu rezulton se vendimet e gjykatës për caktimin e masave të sigurimit nuk janë ankimuar as nga të arrestuarit/ndaluarit.

Masat e sigurimit arrest në shtëpi, garanci pasurore dhe detyrim për paraqitje janë kërkuar për vepra penale të lehta si ato të parashikuara nga nenet 291, 137, 174, 199, 178/3 etj.

Masat e sigurimit arrest me burg janë kërkuar dhe dhëne nga gjykata për vepra penale të rënda si ato të parashikuara nga neni 76, 283, 290, etj.

### **Treguesit statistikorë të zgjatjes së afateve të hetimeve paraprake**

Gjatë vitit 2017 janë zgjatur afatet deri në 3 muaj për 29 procedime penale, me 37 persona nën hetim, ndër të cilët 8 me masë sigurimi.

Janë zgjatur afatet deri në 6 muaj për 3 procedime penale me 3 persona nën hetim, ndër të cilët 1 me masë sigurimi.

Duhet theksuar se zgjatjet e afatit të hetimeve për një numër shumë të madh të procedimeve penale kanë ardhur dhe për shkak të moskryerjes në kohë të veprimeve hetimore të mundshme dhe të nevojshme nga problematikat që lidhen me lëvizjet e shpeshta të oficerëve të Policisë Gjyqësore në seksionin e Policisë së Shtetit, emërimit të oficerëve joprofesionistë në këtë seksion, vonesat që lidhen me administrimin e shkresave dhe kthimit të përgjigjeve nga institucionet e sidomos nga kompanitë e telefonisë celulare si dhe nga mungesa e ekspertëve të të gjitha fushave në Rrethin Tropojë, administrimit me vonesë sidomos të akteve të ekspertimit kimik të bimëve narkotike apo dhe armëve të zjarrit.

Zgjatjet e afatit të hetimeve janë bërë për procedime penale për veprat penale të parashikuara nga nenet 145, 139, 283, 275, 290, 248, etj.

#### **Treguesit statistikorë të Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë**

Gjatë vitit 2017, ka pasur 1 rast të ekstradimit për jashtë shtetit të një shtetasi shqiptar, i cili kërkohet nga autoritetet gjyqësore të shtetit Kosovë. Në përfundim të shqyrtimit gjykata ka pranuar kërkesën duke vendosur ekstradimin e tij.

Po ashtu është ekstraduar nga jashtë shtetit një person i shpallur në kërkim ndërkombetar si i dënuar nga Gjykata e Shkallës së Parë Tropojë për veprën penale të parashikuar nga neni 301 i Kodit Penal.

Janë paraqitur për ekzekutim 24 letër-porosi nga jashtë shtetit, të cilat në të shumtën e rasteve janë letër-porosi të autoriteteve gjyqësore të Kosovës, për njoftimin e akteve shtetasve shqiptarë dhe janë ekzekutuar të gjitha letër-porositë duke iu komunikuar aktet personave sipas kërkesës për ndihmë juridike.

#### **Treguesit statistikorë të ekzekutimit të vendimeve penale për vitin 2017;**

Janë nxjerrë nga Prokuroria urdhërat e ekzekutimit të vendimeve penale për 12 të dënuar me burgim, për 8 të dënuar me gjobë dhe 53 të dënuar me burgim, për të cilët është aplikuar neni 59 i Kodit Penal, për 3 të dënuar është aplikuar neni 63 i Kodit Penal.

Gjatë vitit 2017 rezulton të jenë ekzekutuar vendimet penale për 12 të dënuar me burgim, 53 të dënuar me burgim për të cilët është aplikuar neni 59 i Kodit Penal dhe 3 të dënuar me kusht duke aplikuar nenin 63 të Kodit Penal.

Kanë mbetur të pa ekzekutuara vendime të vitit 2017 për 1 dënim me burgim dhe 8 vendime dënimi me gjobë.

Gjithsej janë mbetur të pa ekzekutuara, të mbartura nga vitet e mëparshme 20 dënime penale me burgim dhe 10 dënime penale me gjobë.

Rezulton se gjatë vitit 2016, ka pasur një përmirësim të punës në ekzekutimin e vendimeve penale nga Zyra e Shërbimit të Provës Tropojë dhe Zyra e Përmbarimit Gjyqësor Tropojë, ndërsa vendimet penale të dënimit me burgim të mbartura nga vitet vijon të jetë një numër shumë i vogël i ekzekutimit të tyre.

**Treguesit statistikorë të përgjithshëm për prokuroëet;**

**Drejtuësi i Prokurorisë Artan Shtrungza**, gjatë vitit 2017 ka hetuar gjithsej 193 procedime penale, nga të cilat ka vendosur dërgimin për gjykim për 46 procedime penale, ka vendosur pezullimin e hetimeve për 11 procedime penale, ka vendosur pushimin e hetimeve për 30 procedime penale, ka mbartur në hetim 77 procedime penale.

**Prokurori Artur Ismajlukaj**, gjatë vitit 2017 ka hetuar gjithsej 113 procedime penale, nga të cilat ka vendosur dërgimin për gjykim për 37 procedime penale, ka vendosur pezullimin e hetimeve për 10 procedime penale, ka vendosur pushimin e hetimeve për 13 procedime penale, ka vendosur transferimin e hetimeve për 1 procedim penal.

Theksojmë se prokurori Artur Ismajlukaj nga muaji tetor 2017 deri në fillim të muajit janar 2018 ka qenë i komanduar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës, prandaj edhe statistika e tij është për periudhën janar-tetor 2018.

**Prokurori Agim Dalipi**, gjatë vitit 2017 ka hetuar gjithsej 42 procedime penale, nga të cilat ka vendosur dërgimin për gjykim për 2 procedime penale, ka vendosur pezullimin e hetimeve për 4 procedime penale, ka vendosur pushimin e hetimeve për 3 procedime penale, ka vendosur transferimin e hetimeve për 1 procedim penal, ka mbartur në hetim 35 procedime penale.

**Oficeri i Policisë Gjyqësore Elton Hoxha**, gjatë vitit 2017 ka hetuar gjithsej 130 procedime penale. Duhet të theksohet se oficeri i Policisë Gjyqësore Elton Hoxha ka hetuar shumicën e çështjeve penale komplekse dhe voluminoze, duke treguar saktësi, shpejtësi dhe cilësi në kryerjen e veprimeve hetimore dhe përfundimin e procedimeve penale.

**Nga seksioni i Policisë Gjyqësore të Policisë së Shtetit** në komisariatit e policisë Tropojë janë hetuar 176 procedime penale, gjithsej gjatë vitit 2017.

Për sa i përket ngarkesës së punës çojmë se është shumë e nevojshme shtimi i organikës së Prokurorisë Tropojë me një oficer të Policisë Gjyqësore, duke pasur parasysh ngarkesën e madhe që ka krijuar për prokurorët dhe ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale e bën të vështirë mbajtjen e procedimeve penale në hetim nga prokurorët, e po ashtu duke pasur parasysh faktin se në Komisariatit e Policisë Tropojë vijon të ketë mungesa të theksuara si në numrin e oficerëve të Policisë Gjyqësore dhe në profesionalizmin e atyre që janë.

Nisur pikërisht nga këto mangësi dhe problematika, nga të dhënat statistikore rezulton se rreth 40% e procedimeve penale janë hetuar nga 2 prokurorët në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë dhe 1 OPGJ, ndërsa 60% e procedimeve penale nga krejt seksioni i Policisë Gjyqësore pranë Komisarariatit të Policisë Tropojë.

**Nga të dhënat statistikore rezulton se gjatë vitit 2017**, ka pasur një rritje të lehtë prej 10%, të numrit të procedimeve penale dhe kallëzimeve penale të regjistruara.

Vërehet se ka një shtim të procedimeve penale në fushën e vjedhjes së energjisë elektrike, shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor, mashtrimit me sigurimet, ndërtimit të paligjshëm, ndërsa veprat penale kundër jetës dhe shëndetit, vjedhjes së pasurisë, kultivimit të bimëve narkotike, kanë pasur rënie të procedimeve penale të regjistruara.

**Për sa i përket ngarkesës së punës** Prokurorëve dhe Oficerëve të Policisë Gjyqësore si dhe Oficerëve të Shërbimeve të Policisë Gjyqësore procedimet penale janë ndarë në bazë të shortit elektronik dhe listës së gatishmërisë dhe nuk ka pasur ndonjë problematikë për t'u shënuar.

Gjatë periudhës njëvjeçare nga drejtuesi i prokurorisë nuk ka pasur raste të shfuqizimit të vendimeve të prokurorëve ose ushtrimi i apelimeve për vendime të themelit, ku është përfaqësuar akuza nga prokurorët e kësaj prokurorie. Pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve në Kodin e Procedurës penale janë zbatuar me përpikmëri përcaktimet në lidhje me punën dhe kompetencat e prokurorëve dhe drejtuesit të prokurorisë.

**Përsa i përket stafit në përgjithësi** ju është kërkuar një zbatim me korrektësi i disiplinës në punë dhe etikës së tyre gjatë ushtrimit të detyrës. Gjithashtu për të gjithë urdhërat dhe udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm të ardhur në Prokurori, janë njohur me to të gjithë punonjësit, konkretisht Prokurorët dhe Oficerët e Policisë Gjyqësore.

**Për sa i përket pagesës së gatishmërisë dhe të mbikohës së punës**, për Prokurorët, Oficerët e Policisë Gjyqësore këto janë përlllogaritur sipas raportit të mbajtur për orët e punës jashtë orarit zyrtar të punës në zbatim të urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm për pagesën e shërbimit të gatishmërisë.

### ***Problematika që lidhen me vonesat e hetimeve***

Një pjesë të problematikave për arsyet e vonesave në përfundimin e çështjeve penale në kohë dhe me cilësi rezulton se janë mungesa e oficerëve të Policisë Gjyqësore specialistë në seksionin e Policisë së Shtetit, lëvizjet e shpeshta të oficerëve të Policisë Gjyqësore, problematikat që lidhen me vonesat e kthimit të përgjigjeve e sidomos përgjigjet e tabulateve të telefonatave nga kompanitë celulare, të cilat shumë herë vonojnë kthimin e përgjigjeve deri në dy muaj, e po ashtu në shumë raste dhe të ekspertimeve etj.



Po ashtu mungesat e theksuara të ekspertëve në Rrethin Tropojë bëhen shkak i vonesave të hetimeve, pasi rezulton se i vetmi ekspert i licensuar në Rrethin Tropojë është eksperti mjekoligjor, i cili dhe ai përpilon aktet e ekspertimit vetëm kur dëmtimet e personave janë të lehta, por nuk kryen në asnjë rast autopsinë e viktimave.

Një problematikë tjetër kanë qenë edhe lëvizjet në stafin e prokurorëve pasi duhet theksuar së gjatë vitit 2017 ka pasur tre komandime prokurorësh, të cilat kanë ndikuar në vonesat e hetimit.

### **Problematikat me seksionin e Policisë Gjyqësore pranë Komisarariatit të Policisë Tropojë**

Vihet re se në seksionin e Policisë Gjyqësore në Policinë e Shtetit ka akoma mungesa në organikën e saj sidomos mungesa e vazhdueshme prej shumë vitesh e zyrës së oficerit të Policisë Gjyqësore, si dhe mungesa e oficerëve profesioniste, e cila në shumë raste është bërë shkak edhe për vonesën e hetimeve dhe moszbulimin e autorësisë së veprave penale. Po ashtu është shumë problematike lëvizja e shpeshtë e oficerëve të Policisë Gjyqësore në seksionin e Policisë Gjyqësore në Policinë e Shtetit që siç e kemi cituar më sipër është bërë pengesë në hetimin e shpejtë të procedimeve penale si dhe në cilësinë e hetimit.

Për sa më sipër kërkohet një vëmendje më e madhe e drejtuesve të policisë për sa i përket plotësimit të organikave dhe mundësisë që lëvizjet e oficerëve të Policisë Gjyqësore të jenë sa më të kujdesshme, gjithmonë në interes të ushtrimit me efikasitet të ndjekjes penale.

Gjithsesi duhet theksuar se Policia Gjyqësore pranë Komisarariatit të Policisë Tropojë ka përballuar një volum shumë të madh pune, nisur edhe nga aksionet e Policisë së Shtetit kundër disa fenomeneve të informalitetit, si ajo e kultivimit të bimëve narkotike, drejtimit të automjeteve pa dëshmi aftësie, vjedhjes së energjisë elektrike, organizimit të llotarive të paligjshme.

Drejtuesit e Prokurorisë Tropojë, por dhe stafi prokurorë dhe oficerë të Policisë Gjyqësore kanë pasur një bashkëpunim të mirë dhe korrekt institucional dhe ligjor me drejtuesit e policisë në rreth si dhe me drejtuesit e policisë në qark, nga të cilët kemi gjetur bashkëpunim dhe mirëkuptim shumë të mirë dhe falë bashkëpunimit, komunikimeve dhe mirëkuptimit të vazhdueshëm mes prokurorëve dhe drejtuesve të policisë është bërë e mundur që problematikat e mësipërme të minimizohen dhe të arrihen rezultate të mira gjatë punës së përbashkët në hetimin e çështjeve penale.

Po ashtu duhet theksuar se është vërejtur një kërkesë llogari shumë më e madhe nga drejtuesit e policisë e sidomos nga Drejtuesit e Policisë së Qarkut Kukës ndaj oficerëve të Policisë Gjyqësore të seksionit të Policisë së Shtetit në Komisarariatin e Policisë Tropojë, vëmendje që ka shërbyer në përmirësimin e punës nga ky seksion i Policisë Gjyqësore.

Për sa i përket marrëdhënieve me drejtues të institucioneve të tjera si gjykatë, polici, ato kanë qenë korrekte në shërbim të mbarëvajtjes së punës dhe marrëdhënieve ndërinstytucionale.

### **Informacion mbi administrimin e prokurorisë**

Gjatë vitit 2017, ka pasur zbatim të rregullt të buxhetit dhe shpenzimeve, të cilat në çdo rast janë dokumentuar me urdhërat përkatës, krijimin e komisioneve të prokurimit, urdhër-xhirime, urdhëra për hyrjen dhe daljen e të gjitha burimeve dhe materialeve në prokurori.

Për sa i përket komunikimit me mediat nuk kemi pasur raste interesimi të tyre, ndërsa për sa i përket pjesës së informimit të publikut, të gjithë shtetasit e interesuar kanë marrë informacionin e duhur në një kohë shumë të shpejtë, pa vonesa me shkrim, por edhe verbalisht dhe nuk ka pasur ankesa për sa më sipër.

Regjistrat dhe raportet janë mbajtur rregullisht nga drejtuesi i prokurorisë dhe zyra e Sekretarisë dhe Regjistratit, si dhe kemi pasur një përdorim të rregullt të sistemit CAMS.

Gjatë punës nga i gjithë stafi i prokurorëve dhe oficerëve të Policisë Gjyqësore, por dhe pjesës së administratës ka pasur një respektim rigoroz të disiplinës në punë dhe etikës dhe nuk kemi patur problematika për sa më sipër.

Shihet si e nevojshme duke sjellë në vëmendje të Prokurorisë së Përgjithshme edhe fakti se Prokuroria Tropojë nuk ka të punësuar një punonjës të specialistit të teknologjisë, funksion të cilin aktualisht e mbulon punonjësi në Prokurorinë Kukës. Për sa më sipër plotësimi i këtij pozicioni pune në Prokurorinë Tropojë me një punonjës të përhershëm do të ishte një ndihmë duke pasë parasushe dhe ngarkesën e veprimeve që kryehen online si me regjistrin elektronik të procedimeve penale, sistemin e menaxhimit të çështjeve penale, por edhe ato të financës.

### **Prioritetet e punës për vitin 2018**

Për sa i përket vitit 2018, prioritetet kryesore të punës sonë do të përqendrohen për të përfunduar sa më shpejt procedimet e mbartura nga viti i kaluar brenda afatit të hetimeve, si dhe hetimi në kohë të shpejtë dhe me cilësi të procedimeve penale gjatë vitit 2018.

Prioritet i punës tonë përveç të tjerave gjatë vitit 2018, do të jetë rritja e efektivitetit të punës dhe ndjekjes penale për vepra penale të krimit ekonomik dhe korrupsionit, trafiqeve të paligjshme, prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, kultivimit të lëndëve narkotike.

Po ashtu një kujdes më i madh do t'i kushtohet mbikqyrjes së ekzekutimit të vendimeve penale si ato me burgim të mbartura nga vitet e kaluara, të cilat gjatë vitit 2017 janë ekzekutuar në numër të pakët.

**DREJTUESI I PROKURORISË**

**ARTAN SHTRUNGZA**